

V E N D I M
Nr.177, datë 25.4.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.351, DATË 30.6.1993 “PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR PASUNIVERSITAR DHE KLASIFIKIMIN E PUNONJËSVE PEDAGOGJIKË E KËRKIMORË”

Me propozim të Komisionit të Kualifikimit Shkencor, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.351, datë 30.6.1993, pika 4.2.1 ndryshohet si vijon:

“”Profesor” emërtohet punonjësi pedagogjik i shkollave të larta me përvojë të gjatë mësimdhënieje, që është autor tekstesh origjinale universitare, hartues programesh për lëndë a cikle speciale, autor arikujsh shkencorë e monografish, që ka drejtuar katedra ose që ka qenë titullar lëndësh a grup lëndësh, ka udhëhequr diploma të SHPU ose të shkollës së lartë dhe si rregull disertacione, si dhe që zotëron disa gjuhë të huaja, për dy nga të cilat ka dëshminë përkatëse”.

2. Pika 4.2 ndryshohet si vijon:

“”Asistent profesor” emërtohet punonjësi pedagogjik i shkollave të larta me përvojë të gjatë mësimdhënieje, që është autor tekstesh universitare, autor artikujsh e monografish, që ka udhëhequr diploma të SHPU ose të shkollës së lartë dhe si rregull disertacione, si dhe që zotëron dy gjuhë të huaja, për të cilat ka dëshmi përkatëse”.

3. Pas pikës 4.2.4, shtohet pika 4.2. a si vijon:

“4.2.a. Dispozitat e kësaj pike vlejnë vetëm për Akademinë e Arteve.

4.2.a.1. Klasifikimi i punonjësve pedagogjikë të lëndëve artistike-profesionale (speciale) në Akademinë e Arteve, si rregull, të mos lidhet me marrjen e gradës shkencore “doktor”.

4.2.a.2. Marrja e gradës shkencore “doktor” është e detyrueshme për pedagogët që zhvillojnë lëndë teorike, të cilët u nënshtrohen plotësisht kërkesave më lart.

4.2.a.3. “Profesor” emërtohet punonjësi pedagogjik me përvojë të gjatë mësimdhënieje, me krijimtari cilësore artistike brënda dhe jashtë vendit, që si rregull është autor tekstesh origjinale të shkollës së lartë, hartues programesh për lëndë e cikle speciale, që ka drejtuar katedër ose ka qenë titullar lënde a grup-lëndësh, që ka udhëhequr diploma universitare e pasuniversitare dhe që ka dëshmitë përkatëse për zotërimin e dy gjuhëve të huaja.

4.2.a.4. “Asistent profesor” emërtohet punonjësi pedagogjik me përvojë të gjatë mësimdhënieje, me krijimtari cilësore artistike, që si rregull është autor tekstesh të shkollës së lartë, që ka qenë titullar lëndësh, ka udhëhequr diploma dhe ka dëshmitë përkatëse për zotërimin e dy gjuhëve të huaja.

4.2.a.5. “Pedagog” emërtohet punonjësi pedagogjik që, në mungesë të gradës shkencore “doktor”, ka fituar tri provime pasuniversitare të drejtimit metodiko-pedagogjik e teorik, si dhe test-provimin e praktikës mësimor (mësim i hapur), që i jep mësim sipas programit dhe teksteve të autorëve të tjerë, që ka udhëhequr diploma dhe ka dëshminë e zotërimit të një gjuhe të huaj.

4.2.a.6. “Asistent” emërtohet kuadri i lartë i atashuar për punë ndihmëse pranë katedrës ose mësimdhënësve të tjerë”.

4. Pas pikës 7.3 shtohet pika 7.3.a si vijon:

“7.3.a. Dispozitat e kësaj pike shërbejnë deri në fund të vitit 1994.

7.3.a.1. Personat me tituj shkencorë “profesor”, “docent”, “bashkëpunëtor i vjetër shkencor”, në marrëdhënie pune ose jo, të cilët nuk kanë fituar ndonjë gradë shkencore (nuk kanë mbrojtur disertacion), lejohen të paraqesin kërkesë për emërtimet “profesor”, “asistent profesor” përkatësisht “drejtues, mjeshtër kërkimesh”.

7.3.a.2. Personave me veprimtari kërkimore-shkencore e pedagogjike shumëvjeçare, që janë mbi 55 vjeç dhe që për arsye të ndryshme janë penguar të marrin gradë shkencore, u jepet e drejta që deri në datën 31.12.1994 të paraqesin pranë KKSH kërkesën për gradën shkencore “doktor”. Kjo kërkesë do të përmbajë: a) curriculum vitae; b) vlerësim për veprimtarinë kërkimore-shkencore e pedagogjike nga titullari (ose titullarët) e institucionit (institucioneve) ku punon (ka punuar); c)

dëshminë e provimit të një gjuhë të huaj (është i pranueshëm vlerësimi me notën shtatë e lart); ç) një studim a monografi që është botuar ose ka gjetur zbatim në praktikë dhe që i interesuari e paraqet për vlerësim.

KKSH ua dërgon këto materiale institucioneve përkatëse që kanë të drejtë të organizojnë mbrojtjen e doktoratës. Këto të fundit ngrenë një juri të posaçme për vlerësimin e kërkesës dhe për marrjen e vendimit përkatës.

7.3.a.3. Për personat me moshë mbi 50 vjeç që kërkojnë emërtimin “profesor” (“drejtues kërkimesh”), dhe mbi 45 vjeç që kërkojnë emërtimin “asistent profesor” (“mjeshtër kërkimesh”), është e mjaftueshme një dëshmi për zotërimin e gjuhëve të huaja”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi